

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiqi, anëtarë, me zyrtarin ligjor Shaban Prekalla, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.SH., nga Gjilani, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 par.8 lidhur me par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, av.M.M., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.804/18, të dt.29.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 25.02.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.SH., av.M.M., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.804 /18, të dt.29.11.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.804/18, të dt.29.11.2018, është shpallur fajtor i akuzuari B.SH., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 par.8 lidhur me par.1 të KPK dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 120 (njëqind e njëzet) ditëve, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Në kuptim të nenit 47 të KPK dhe me pëlqimin e të akuzuarit B.SH., dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 120 (njëqind e njëzet) ditëve i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 1800 (njëmijë e tetëqind) euro, të cilin dënim do ta paguajë menjëherë pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, po qese i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 120 (njëqind e njëzet) ditë burg.

I dëmtuari E.M. për realizmin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civilo - juridik.

Në bazë të nenit 62 paragrafi 1 dhe 2 nën par. 2.6, të KPK, të akuzuarit B.SH., i shqiptohet edhe dënimi plotësues, marrja e patentë shoferit në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20(njëzet)€, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë mbrojtësi i të akuzuarit av. M.M., për shkak të dënimit me gjobë dhe kohëzgjatjes së dënimit plotësues, duke propozuar që të aprovohet ankesa dhe gjoba të zbutet në përmasë sikur edhe dënimi plotësues, mundësisht të kushtëzohet apo të jetë një afat më i shkurtër.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.118/2019, të datës 08.02.2019, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit av.M.M., ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit av.M.M., nuk është e bazuar

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit av.M.M., aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit për dënimin me gjobë dhe kohëzgjatjes së dënimit plotësues duke theksuar se i akuzuari është mbajtës i vetëm i familjes dhe punon si taksist tek kompania “NN”, dhe nga mjetet që i siguron nga puna mban familjen. Po ashtu në ankesë thekson se i akuzuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, ashtu që ka propozuar që të kenë parasysh këto rrethana e sidomos kur është çështja e dënimit të shqiptuar me gjobë, sepse i akuzuari është i gjendjes materiale jo të mirë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, e ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar sipas ankesës së ushtruar, dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike e cila rezulton në bazë të vlerësimit të deklaratës së të akuzuarit, i cili e ka pranuar fajësinë, për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë, se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjykata e shkallës së parë, me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimin dhe llojin e lartësisë së tij, drejt ka aplikuar dispozitën ligjore nga neni 73 të KPK, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se ka bashkëpunuar me organet të cilat kanë zhvilluar procedurë në këtë çështje penale, se është penduar thellësisht për veprën e kryer penale dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk ka me ra në kundërshtim me ligjin, kurse rrethana rënduese në këtë çështje nuk ka gjetur, andaj drejt ka aplikuar dispozitën ligjore nga neni 76 i KPK, përkitazi me kufijtë e zbutjes së dënimeve. Në prani të këtyre rrethanave e duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, kolegji i kësaj gjykate ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe adekuat të përgjegjësisë penale juridike të akuzuarit, sikurse edhe dënimi plotësues, i cili

është marrë konform dispozitës përkatëse ligjore, ashtu që kolegji i kësaj gjykate është i bindur se me këtë lloj dënimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.97/19, të datës 25.02.2019

Zyrtari ligjor
Shaban Prekalla

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Biljana Rexhiq